
GLOBAL INITIATIVE

RESILIENCE FUND


TFL
TOGETHER FOR LIFE

Skenari: Alma Lahe Realizimi grafik: Kosta Raka

Kur prindi gabon, fëmija e pëson



Ky material u realizua nga Together for Life në kuadër të projektit "Të luftojmë krimin e organizuar dhe mbështesim zhvillimin e të rinjve në Dibër", mbështetur nga Nisma Globale Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar.





1


Çfarë ka ndodhur?

Babai kishte tërhequr lekët e ndihmës ekonomike dhe i kishte pirë në klub. Kur nëna i kërkoi lekët, ai e goditi dhe doli prapë të pijë.

2



Mos u mërzit, moj nënë, do të punoj unë që të siguroj para.
3
E ku do punosh, mor bir? Punë nuk po gjen dot yt atë. Mbaro shkollën njëherë, pa ne do t'ia dalim.
Çfarë shkolle? E ç'më duhet shkolla! Ne kemi nevojë për para,
4


Hë, mo Tani, ç'ke kështu? Ke ndonjë të sëmurë?
Të gjithë të sëmurë jemi, nuk kemi para as për të ngrënë. Po shkoj në Pazar mos gjej ndonjë punë si hamall.
5


Çfarë thua, mor shoku, je i vogël për atë punë. Le që do të këputesh në punë për disa kacidhe. Na merri këto dhe shko të blesh ushqime.
Jooo, nuk mund t'i marr. E ku t'i gjej unë kaq para që të t'i kthej?
LEKE
6


Merri dhe mos bëj fjalë! Nuk ka nevojë të më kthesh gjë. Kur të kem nevojë, do të bësh ndonjë punë për mua.
Punë? Që tani. Më thuaj çfarë duhet të bëj
LEKE
7


Flasim herë tjetër. Tani shko në shtëpi. Nëse je djalë punëtor dhe i zgjuar, do të fitosh shumë më shumë se kaq para sa të dhashë unë.
8


9
10



Mami, Tani po sjell plot gjëra për të ngrënë.

E ku i gjeti paratë? Mos ka vjedhur ndonjë dyqan?


11



12


Pupupuuuuu, ku i more këto ushqime, mor bir?
I bleva, Edi, komshiu, më dha para borxh.
13
Çfarë borxhi, more kopuk? Me çfarë do t'i lajmë borxhet e tua?
Do t'ia lajë unë. Do të bëj ndonjë punë për të, herë pas here. Do ta lë edhe shkollën.
14


Si do ta lësh shkllën?
Çfarë shkolle?
Se mos të ngatërron
me punë të liga?
Lëre moj çunin ti!
Punë të liga, thotë!
Edi është djalë i zoti.
E ke parë si janë rregulluar?
15
Mos e lër shkollën, bir. Shko tek fabrika
e frutave pasditeve. Xhaxhi Hyseni më tha
të shkosh të punosh me të birin, Lulin, që
e ke në klasë. Do pastroni vendin kur të ikin
punëtorët. Nuk është punë e vështirë dhe
fiton ndonjë lekë.
Të punoj për ca kacidhe?
E ke parë Edin? Para dy
vitesh e la shkollën dhe
punon. ka blerë alamet
makine dhe po mbarojnë
katin e dytë të shtëpisë,
Ne në këtë kasolle do të
rrimë?
16


Çuna, ky është Dritani, komshiu im, për të cilin ju kam folur. Është djalë flori dhe me një mijë halle, si ne dikur. Do punojë për ne.
Të lumtë, mor djalë, do bëjmë një mal me lekë bashkë.
Në punën tonë duhet të ruash sekretin. Mos i trego askujt se ç'bën. Nëse të pyesin, ne nuk na njeh, ëëë?
17
Ç'të pista, mo shoku? As mos mendo gjëra të tilla. Janë punë pa rrezik. Tani dëgjo këtu...
Dhe çfarë pune është kjo? Sepse nuk dua të ngatërrohem në punë të pista.
Bëhet fjalë për pare të madhe.Si do t'ia shlyesh borxhin Eduardit?
Mos ki frikë. Ligji kap ata që janë mbi 20 vjeç. Deri atëherë ne do jemi bërë të pasur.
18


Hë shoku, e pe që s'pate problem?
Bravo. Na dhe paratë, i ke hallall.
Gjithçka në rregull.
I shita të gjitha.
LEKE
19
Tani, çohu bir. Kanë vrarë Eduardin.
Pupuuu, unë e zeza...
Çfarë ke? Ke frikë për mua?
20

I dënuan ata dy djemtë që vranë Eduardin. Kishin qenë shokët e tij. Njërin e dënuan me 15 vjet, ndërsa tjetrin me burgim të përjetshëm. I shkreti ai që iku kaq i ri, ndërsa dy të tjerët do ta kalojnë gjithë jetën në burg.

I njihje ti ata dy djemtë që u dënuan?

Jo. Vetëm Edin njihja meqë e kishim komshi.

21



I mbarove mësimet për nesët?

Ku po shkon tani?

Po më pret Luli, që të shkojmë tek fabrika e frutave.

22

